

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE E FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË



LIGJ

Nr. 109/2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 4/2020, "PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARIVE FINANCIARE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 4/2020, "Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje: "2. Përjashtimisht për shkëmbimin e parë automatik, autoriteti kompetent shkëmben informacion me juridiksionet e tjera kompetente brenda datës 31.12.2020."

Neni 2

Pika 1 e nenit 19 ndryshohet si më poshtë: "1. Përjashtimisht për raportimin e parë, institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, raporton brenda datës 15 nëntor 2020 për të gjitha llogaritë e raportueshme ekzistuese në datën 1.1.2019, si dhe llogaritë e raportueshme të hapura përgjatë vitit 2019, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji."

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 29.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11583, datë 5.8.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET

Nr. 11583, datë 5.8.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 109/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 4/2020, 'Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare'".

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ilir Meta

Shkëputur nga Fletorja Zyrtare nr. 146 dt 07.08.2020

